



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada-Government
Ministria e Drejtësisë- Ministarstvo Pravde- Ministry of Justice

Në bazë të Ligjit nr. 04/L-141 për Provimin e Jurisprudencës dhe nenit 4 të Udhëzimit Administrativ nr. 13/2013 për mënyrën e dhënies dhe programin e provimit të jurisprudencës, Ministria e Drejtësisë publikon:

SHPALLJEN PUBLIKE
PËR DHËNIEN E PROVIMIT TË JURISPRUDENCËS

Ftohen të gjithë kandidatët e interesuar të cilët dëshirojnë që të aplikojnë për dhënien e Provimit të Jurisprudencës ne afatin e Qershor 2016 se:
Afati për dorëzimin e aplikacioneve për dhënien provimit të jurisprudencës fillon prej datës **30 Maj 2016 deri me datë 03 Qershor 2016**.

Kërkesës për dhënien e provimit të jurisprudencës e cila merret ne Faqen Zyrtare te Ministrisë së Drejtësisë, duhet t'i bashkëngjisni dokumentet e vërtetuara me të cilat dëshmohet se i plotëson kushtet ligjore, si në vijim:

- Diplomën e Fakultetit Juridik, sipas programit katër vjeçar ose studimet master, kopja e Diplomës duhet te jete e NOTERIZUAR;
- Vërtetimin për përvojën e punës juridike pas diplomimit konform nenit 6 të Ligjit Nr. 04/l-141 për Provimin e Jurisprudencës, Vërtetimi duhet te dorëzohet kopje e NOTERIZUAR;
- Certifikatën e shtetësisë së Republikës së Kosovës;
- Nëse kandidati fakultetin e ka të përfunduar në shtetin tjetër, atëherë kandidati duhet ta sjell diplomën e nostrifikuar dhe Vendimin nga Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë e Republikës së Kosovës. Diploma dhe Vendimi duhet te dorëzohen kopje te NOTERIZUARA.

Dokumentacioni i pakompletuar sipas kërkesave te përcaktuara ne konkurs, është bazë që Komisioni të refuzoj Kërkesën për lejimin e dhënies së Provimit të Jurisprudencës.

Kandidatët të cilët kanë mbetur në riprovim nga afati i Marsit 2016 duhet ta paraqesin kërkesën brenda këtij afati për të ju nënshtruar Riprovimit ne afatin e Qershorit 2016.

Kandidatëve të cilëve me parë ju është aprovuar kërkesa për dhënien e provimit të Jurisprudencës, e të cilët dëshirojnë t'i nënshtrohen Provimit në këtë afat, duhet të paraqesin kërkesë për dhënien e provimit të jurisprudencës, e cila duhet të përmbajë të dhënat personale dhe vitin në të cilin ju është lejuar dhënia e provimit të Jurisprudencës.

Kërkesa për dhënien e provimit të jurisprudencës dorëzohet në Ministrinë e Drejtësisë, Ish-Ndërtesa e Rilindjes Kati përdhese Arkivi i Ministrisë së Drejtësisë, Prishtinë, Republika e Kosovës, çdo ditë pune, nga ora 08:00 deri 16.00.

Kandidatit me vendim i lejohet hyrja në provimin e jurisprudencës.

Për datën, kohën dhe vendin e mbajtjes së provimit me shkrim dhe me gojë kandidatët do të njoftohen përmes njoftimit te publikuar ne faqen zyrtare të Ministrisë së Drejtësisë.

Për informata të hollësishme mund të drejtoheni në faqen zyrtare te Ministrisë së Drejtësisë <http://www.md-ks.org>, apo kontaktoni në, tel: 038 200 18 353.